



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA E POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR

PARASHTRIME

“Në lidhje me çështjen (JR) nr. 56/2024, datë 27.12.2024, që i përket subjektit të rivlerësimit Eranda Laze”

Kërkues/Apelues: Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, përfaqësuar nga Drejtuesi i Prokurorisë, **z. Altin Dumani**, si dhe nga prokurori, **z. Adnan Xholi** (me autorizim).

Objekti: Parashtrime të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme në seancë gjyqësore, para trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në çështjen ankim kundër vendimit me nr. 811, datë 8.11.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, **zj. Eranda Laze**.

Baza ligjore: Neni 179/b, pika 5 dhe 8 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Data e seancës: 25.6.2025

Përpara: GJYKATËS KUSHTETUESE

KOLEGJIT TË POSAÇËM TË APELIMIT

TIRANË

E nderuar znj. kryesuese e Trupit Gjykses!

Të nderuar gjyqtarë, të Kolegjit të Posaçëm të Apelim!

Pasi u informuam me njoftimin e Kolegjit të Posaçëm të Apelim nr. 56/4 Regj, datë 13.5.2024 mbi zhvillimin e gjykimit të çështjes në seancë publike më datë 25.6.2025, në lidhje me çështjen (JR) nr. 56/2024, datë 27.12.2024, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Eranda Laze, parashtrojmë si më poshtë vijon:

I. RRETHANAT PROCEDURALE

1. Në zbatim të nenit 179/b, pika 8 të Kushtetutës, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar Tiranë (në vijim Drejtuesi i Prokurorisë), ushtron kompetencat e Komisionerëve Publikë pas shpërbërjes së tyre, mbarimi i mandatit të të cilëve ka ndodhur më datë 31.12.2024, referuar parashikimit kushtetues në ligjin me Nr. 16/2022 “Për një ndryshim në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

1.1 Drejtuesi i Prokurorisë, në mbështetje të përcaktimeve të nenit 148/dh, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 15, pika 2, gërma “g” të ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, i ndryshuar, si dhe nenit 38, pika 3 të ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ka autorizuar **z. Adnan Xholi**, me funksion Prokuror pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, (njëkohësisht Drejtuesi i Seksionit kundër Krimit të Organizuar dhe Terrorizmit), që të përfaqësojë në Kolegjin e Posaçëm të Apelim, në seancë publike çështjen (JR) nr. 56/2024, datë 27.12.2024 lidhur me ankimin e Komisionerit Publik, kundër vendimit nr. 811, datë 8.11.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, **zj. Eranda Laze**.

1.2 Në zbatim të kësaj kompetence të Drejtuesit të Prokurorisë në procesin e rivlerësimit, i cili është ngritur me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë si dhe rikthimi i besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi, si përfaqësues i interesit publik i qëndroj ankimit me nr.479/6 prot., datë 20.12.2024 të Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 811, datë 8.11.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim Komisioni), për subjektin e rivlerësimit, zj. Eranda Laze.

1.3 Referuar akteve të administruara në dosjen e procesit të rivlerësimit, më datë 6.12.2024 është njoftuar vendimi nr. 811, datë 8.11.2024, i Komisionit të Pavarur të

Kualifikimit, i cili me shumicë votash¹ ka vendosur për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, zj. Eranda Laze, me funksion prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Vlorë, aktualisht prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë.

1.4 Ndaj këtij vendimi, bazuar në nenin B, pika 3, gërma “c”, të aneksit të Kushtetutës, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 6.12.2024, është depozituar akti: “*Rekomandim për paraqitje ankimi*”, nr. prot., 397/1, datë 6.12.2024², nënshkruar nga një komision prej tre vëzhguesish ndërkombëtarë të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit.

1.5 E drejta e ankimit ndaj vendimit nr. 811, datë 8.11.2024, të Komisionit është ushtruar në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2, të aneksit të Kushtetutës, nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, dhe në zbatim të Rekomandimit të ONM-së, datë 6.12.2024. Ankimi, në rastin konkret, evidenton dhe parashtron si çështje për gjykim, rrethana dhe fakte ligjore, për të cilat ndajmë qëndrim të ndryshëm nga vlerësimi i Komisionit.

1.6 Drejtuesi i Prokurorisë, në ushtrimin e kompetencës së tij në procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, duke iu qëndruar të gjitha shkaqeve të parashtruara gjerësisht në ankimin e datës 20.12.2024, kundër vendimit nr. 811/2024 të Komisionit, para këtij trupi gjykues, parashtron në mënyrë të përmbledhur, si vijon:

I. A. Lidhur me vlerësimin e kriterit të pasurisë

2. Apartament banimi me sipërfaqe 181,2 m², në *, Tiranë, vlera 81.284 euro**

2.1 Në *D-Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Dy apartamente banimi të bashkuar në 1³, në bashkëpronësi me bashkëshortin, me sipërfaqe totale 181,2 m², të ndodhur në ***, Tiranë⁴. Vlera: 81.284 euro. Pjesa takuese: 50%. Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar burimin e krijimit, ndërsa bashkëshorti i subjektit, për të njëjtën pasuri, në D-Vetting ka deklaruar si burim krijimi: (i) Kursimet nga emigracioni; (ii) Kursimet nga aktiviteti privat dhe publik i ushtruar në harkun kohor 2004 – 2008, të deklaruara në kohë, në shumën prej 40.000 euro; si dhe (iii) Shuma e kredisë e marrë për këtë qëllim⁵.*

¹ Relatorja e trupit gjykues znj. **. **. ka votuar “kundër” konfirmimit në detyrë të subjektit të rivlerësimit.

² Protokolluar pranë IKP-së me nr. ***/** prot., datë **.12.2024.

³ Bashkëlidhur certifikata e pronësisë nr. serie *** dhe nr. serie ***, datë **.2.2015, të lëshuar nga ZRPP Tiranë.

⁴ Sqaroj se kjo pasuri është deklaruar me të dhëna sipas kontratës premtim shitje të lidhur me firmën ndërtuese në datë **.12.2009, me nr. *** rep. dhe nr. *** kol. (Numri i koleksionit duket se është shënuar gabim material).

⁵ Në dosje të Komisionit janë të administruara: (a) kontratë prenotim shitje nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.12.2009, nënshkruar midis përfaqësuesit të shoqërisë “****” sh.p.k. dhe z. *** ***, për prenotimin e dy apartamenteve me sip. 89 m² dhe 114,21 m², në L. *** të Komunës ***, Tiranë; (b) kontratë nënsipërmarrje nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.8.2007, e lidhur midis përfaqësuesve të shoqërisë “****” sh.p.k. në cilësinë e palës nënsipërmarrëse dhe shoqërisë “****” sh.p.k., në cilësinë e palës porositëse, nëpërmjet së cilës shoqëria “****” sh.p.k. vë në dispozicion të shoqërisë “****” sh.p.k. një pjesë trualli për ndërtim, pasi leja e ndërtimit të KRRT-së, Komuna *** për ndërtimin e një godine banimi i është dhënë me vendimin nr. **,

2.2 Në DV-2010, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Dy apartamente banimi të bashkuar në 1, sip. totale 203,21 m², pranë Bar “****”, Komuna ***, Tiranë, prenotuar në bazë të kontratës së prenotimit nr. ***/***, dt. **.12.2009, notere **.***. Pagar 40.000+30.000 euro. Vlera: 81.284 euro. p.s.: kontrata e nënshkruar nga bashkëshorti. E deklarohet këtë vit, pasi edhe pse e regjistruar në 2009, kontrata u mbyllt pasi u lëvrua kredia bankare prej 30.000 euro në 2010.*

2.3 Në DV-2009, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Kursimet nga paga vjetore e vitit 2008, 200.000 lekë, ndërsa bashkëshorti i subjektit në cilësinë e personit të lidhur me subjektin, ka deklaruar: Të ardhurat nga profesioni i lirë “avokat”, 2.500.000 lekë. Në këtë deklaratë, nuk janë deklaruar kontrata e prenotim shitjes e datës **.12.2009, nr. *** rep., nr. *** kol..*

2.4 Në DV-2008, bashkëshorti i subjektit, në deklarin e tij të parë në cilësinë e personit të lidhur me subjektin, ka deklaruar: *(i) Një apartament me sipërfaqe 80 m², të ndodhur në lagjen “** **”, Vlorë (kontratë premtim për shitje datë **.4.2008, nr. *** rep., nr. *** kol., noter **.***), me vlerë 52.000 euro dhe pjesë takuese 100%; (ii) Një shtëpi private e përbërë nga dy dhoma një kuzhinë me sipërfaqe trualli 200 m², të ndodhur në Durrës, pjesa takuese 50%; (iii) Depozitë bankare pranë Bankës *** Vlorë, 10.000 euro; (iv) Kursime 30.000 euro. Burim krijimi ka deklaruar: (i) të ardhura nga emigracioni 1996 – 2004; (ii) të ardhura nga aktiviteti privat 2004 – 2006; (iii) të ardhura nga aktiviteti publik 2006 – 2008.*

2.5 Komisioni ka analizuar në mënyrë të detajuar gjithë burimet e deklaruara nga subjekti dhe personi i lidhur me të, për blerjen e kësaj pasurie, në shumën 81.284 euro (si vlerë totale të blerjes së dy apartamenteve), sipas deklarimeve të bëra në Deklaratën “Vetting” dhe ato periodike vjetore, analizë nga e cila në përfundim të hetimit administrativ, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, pasi, ndër të tjera, ka konstatuar se:

2.5.1 *Subjekti dhe personi i lidhur nuk kanë pasur mundësi financiare që me të ardhura të ligjshme të paguajnë në datën **.12.2009 këstin prej 40.000 euro, pasi kanë rezultuar me balancë negative në shumën - 6.408.671 lekë në analizën e kryer për vitin 2009⁶.*

datë **.12.2006, shoqërisë “****” sh.p.k.; (c) certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë **.2.2015, për apartamentin me sip.80 m² me nr. pasurie ***/**+***-**, vol. **, faqe **, z. k. ***, së bashku me kartelën e pasurisë, ku është përcaktuar se shuma e paguar për këtë apartament është 4.240.000 lekë; (d) certifikatë për vërtetim pronësie nr. *** për pasurinë nr. ***/**+***-**, vol. **, faqe 40, për apartamentin me sip. 101,2 m², së bashku me kartelën e pasurisë, ku është përcaktuar se shuma e paguar për këtë apartament është 5.363.600 lekë; (e) Kontratë shitje me nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.12.2024, nënshkruar ndërmjet shoqërisë “****” sh.p.k. dhe z. *** ***, për shitjen e apartamentit me sip. 101,2 m² në çmimin 5.363.600 lekë dhe 80 m² në çmimin 4.240.000 lekë.

⁶ Komisioni ka kryer dhe analizën financiare për burimet e ligjshme të pasurive të deklaruara në DV-2008, për të cilat i ka kaluar subjektit barrën e provës pasi ka konstatuar se: *Subjekti dhe personi i lidhur nuk kanë pasur mundësi financiare që me të ardhura të ligjshme të kursejnë vlerat e deklaruara në deklaratën fillestare të pasurisë të vitit 2008, konkretisht depozitën bankare në vlerën 10.000 euro dhe kursimet cash*

2.5.2 Lidhur me pagesën e këstit të fundit në vlerën 11.284 euro sipas mandat arkëtimit datë **.1.2014, subjekti i rivlerësimit duhet të provojë burimin e ligjshëm të pagesës, pasi nga analiza financiare e kryer nga Komisioni rezultoi se subjekti dhe bashkëshorti i saj nuk kanë pasur mundësi të kryejnë me të ardhura të ligjshme, pagesën e këstit të fundit, pasi kanë rezultuar me balancë negative në shumën -1.544.990 lekë.

2.6 Në përgjigje të barrës së provës⁷ subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar konkluzionet e Komisionit, duke pretenduar, ndër të tjera, moskualifikimin e bashkëshortit si person i lidhur ose person tjetër i lidhur, në kuptim të ligjit nr. 84/2016, për kohën përpara lidhjes së martesës ligjore në datën **.9.2008 dhe marrjen në konsideratë të faktit se, pasuritë e krijuara dhe deklaruar nga bashkëshorti në DV 2008 (të luajtshme dhe të paluajtshme), kanë qenë në pronësi të plotë të tij dhe janë blerë me të ardhurat e tij përpara se të njihej me subjektin.

2.6.1 Përveç sa më sipër, në prapësimet e saj, subjekti ka pretenduar edhe rishikimin e disa prej zërave të analizës financiare të kryer nga Komisioni, konkretisht: (i) të ardhurat nga emigracioni të bashkëshortit dhe faktin që ky i fundit, në periudhën e krijimit të këtyre të ardhurave, ka qenë pjesë e ekonomisë së përbashkët familjare. Për këtë arsye ka kërkuar rishikimin e të ardhurave familjare dhe shpenzimeve të jetesës së tij, duke pretenduar se këto të fundit janë mbuluar nga familjarët e bashkëshortit; (ii) të ardhurat nga punësimi i bashkëshortit nga aktiviteti privat për periudhën 2004-2006; (iii) të ardhurat e bashkëshortit nga aktiviteti si “avokat” për vitin 2009; (iv) rishikimin e shpenzimeve të udhëtimeve të kryera në vitin 2009, duke zbritur udhëtimet e kryera për arsye pune, në funksion të aktivitetit të tij⁸.

2.6.2 Subjekti ka kundërshtuar analizën financiare të kryer nga Komisioni edhe lidhur me pagesën e këstit të fundit të pasurive në shumën 11.284 euro në datën 10.1.2014, duke pretenduar se: [...] *para nënshkrimit të kontratës u nënshkrua mandati i datës **.1.2014, sepse mungonte dokumenti justifikues për pagesën e mbetur, por shuma prej 10.000 euro i është likuiduar shoqërisë shitëse në fund të vitit 2010 ndërsa shuma prej 1.284 euro në fund të vitit 2013 [...]*.

2.7 Komisioni, pas vlerësimit të shpjegimeve dhe provave të subjektit, në përfundim, ndër të tjera, ka arritur në përfundimin se⁹: [...] *në analizë të provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit, ndër të tjera çmon se rezulton e provuar se personi i lidhur, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, gëzon statusin e personit të lidhur nga data*

në vlerën 30.000 euro, pasi kanë rezultuar me balancë negative në shumën – 6.830.100 lekë në analizën e kryer për periudhën dhjetor 1998 – 26 shtator 2008.

⁷ Në aktin “Shpjegime për Rezultatet e Hetimit Administrativ” të datës **.11.2024.

⁸ Për më tepër referohuni prapësimeve të subjektit ndaj rezultateve të hetimit administrativ, në dosje të Komisionit.

⁹ Referohuni prg. 3.22 e në vijim të vendimit të arsyetuar të Komisionit.

***9.2008, datë në të cilën ata kanë filluar bashkëjetesën pas lidhjes së martesës ligjore... trupi gjykues çmon se subjekti dhe personi i lidhur kanë pasur mundësi financiare të paguajnë në datën **12.2009 këstin prej 40.000 euro... Lidhur me kohën se kur subjekti dhe personi i lidhur kanë kryer pagesën e vlerës 10.000 euro, Komisioni ka vlerësuar se subjekti dhe personi i lidhur kanë kryer pagesën 10.000 euro në fund të vitit 2010 dhe transfertat, derdhjet dhe tërheqjet (e evidentuara gjatë hetimit administrativ) në llogarinë e personit të lidhur, nuk duhet të përfshihen në analizën financiare të vitit 2010 si shpenzime të periudhës [...].*

2.8 Drejtuesi i Prokurorisë, për sa më sipër, ndan qëndrim të ndryshëm lidhur me vlerësimin e Komisionit mbi statusin e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, si dhe vlerësimin e burimeve të ligjshme të pasurive të deklaruara, për sa vijon:

2.8.1 Vlerësimi i Komisionit, se bashkëshorti i subjektit gëzon statusin e personit të lidhur nga data e lidhjes së martesës ligjore, duket se nuk mbështetet nga situata faktike dhe rrethanat e çështjes. Sikundër ka rezultuar nga aktet në dosje, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka blerë një pasuri të llojit apartament me vendodhje në qytetin e Vlorës në prill 2008, pasuri, e cila është përdorur pa kompensim nga vetë subjekti, përpara martese dhe gjatë ushtrimit të detyrës, për periudhën shtator 2007 deri në korrik 2008, referuar deklarimeve të subjektit gjatë hetimit administrativ, edhe pse formalizimi i blerjes së apartamentit është kryer në prill 2008. Kjo pasuri, është deklaruar gjithashtu nga subjekti në Deklaratën Vetting, si pasuri në posedim dhe si adresë banimi në momentin e plotësimit të deklaratës.

2.8.2 Lidhja e interesit të subjektit me bashkëshortin përpara martese, konfirmohet si nga deklaratimet e subjektit gjatë hetimit administrativ¹⁰, ashtu dhe referuar aksesit të subjektit të rivlerësimit në llogarinë bankare të bashkëshortit, përpara martese, në cilësinë e bashkëmbajtëses së llogarisë¹¹.

2.8.3 Në këtë këndvështrim, në përputhje me parashikimet e nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm të procesit të rivlerësimit, subjekti i rivlerësimit ka detyrimin të provojë ligjshmërinë e burimeve të krijimit të pasurive të deklaruara.

2.8.4 Për sa i përket konkluzioneve të Komisionit mbi burimet e ligjshme të pagesës së kështit të parë të apartamenteve, në vitin 2009 në shumën 40.000 euro, Drejtuesi i Prokurorisë, sa i takon burimit të deklaruar: *kursime nga emigracioni*, i gjen të pambështetura në aktet në dosje dhe jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit, pretendimet e subjektit mbi ekonominë e përbashkët familjare dhe mbulimin e shpenzimeve të jetesës

¹⁰ Referohuni pyetësorit standard të datës 26.1.2011.

¹¹ Bazuar në shkresën e *** Bank (ish ***) me nr.*** prot, datë **9.2024 ka rezultuar akses në llogarinë e E.L. nr.*** në *** Bank.

të bashkëshortit nga familjarët e tij, pretendime të cilat rezultojnë të jenë paraqitur gjatë hetimit administrativ dhe në funksion të mbështetjes së shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit. Lidhur me arsyetimin e Komisionit mbi *të ardhura nga punësimi i bashkëshortit për periudhën 2004-2009*, në referencë dhe të jurisprudencës së Kolegjit, vlerësohet se duhet të konsiderohen në mesin e burimeve të ligjshme, vetëm ato të ardhura të cilat provohen me dokumentacion justifikues dhe plotësojnë kushtet e parashikuara në nenin D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës.

2.8.5 Sa më sipër, nga aktet në dosje, vlerësohet se, edhe në përfundim të hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e barrës së provës për pagesën e këstit të parë të pasurive apartament banimi në Tiranë. Në këtë kontekst, për sa kohë që nga analiza financiare e kryer deri në fund të vitit 2008, në gjendjen që janë aktet, mbetën të paprovuar burimet e ligjshme të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, për të krijuar pasuritë e deklaruar, kursimet në llogaritë bankare dhe ato *cash*, kurse të cilat janë deklaruar si burim për financimin e pasurive apartament objekt hetimi, këto të fundit, nuk mund të përfshihen në analizën financiare të vitit 2009.

2.9 *Për sa i përket konkluzioneve të Komisionit mbi burimet e ligjshme për pagesën e këstit të fundit prej 11.284 euro*, Drejtuesi i Prokurorisë, në zbatim të Rekomandimit të ONM-së, vlerëson se konkluzioni i Komisionit lidhur me *momentin* e pagesës së këstit të fundit të apartamenteve në Tiranë, nuk mbështetet në aktet e administruara në dosje.

2.9.1 Referuar kontratës “*Prenotim shitjeje*” nr. ** rep, nr. ** kol., datë **.12.2009, lidhur midis përfaqësuesit të shoqërisë “****” sh.p.k. dhe prenotuesit të apartamentit, z. *** (bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit), parashikohet se: [...] *prenotuesi do të quhet pronar i këtij apartamenti pasi të ketë shlyer vlerën prej 81.284 euro me këto këste: Kësti i parë në datën e sotme të nënshkrimit të kësaj kontrate, në shumën prej 40.000 euro; Kësti i dytë prej 30.000 euro do të shlyhet në datën e lëvrimit të kredisë për të cilën ka aplikuar; Kësti i fundit për shumën e mbetur do të shlyhet në momentin e dorëzimit të apartamentit të përfunduar [...].*

2.9.2 Nga aktet e vëna në dispozicion nga ZVRPP Tiranë¹² për këtë pasuri, rezulton se janë depozituar dy mandate arkëtimi për blerjen e kësaj prone, respektivisht: 1) mandat arkëtimi nr.***, datë **.12.2009, për pagesën e shumës prej 40.000 euro, me përshkrimin “*Kësti i shtëpisë, arkëtuar nga *** në favor të shoqërisë “**** ” sh.p.k.*”; dhe 2) mandat arkëtimi i datës **.1.2014, për pagesën e shumës prej 11.284 euro, me përshkrimin “*Për blerje apartamenti objekti Tiranë, në favor të shoqërisë “**** ” sh.p.k.*”.

¹² Referohuni dokumentacionit të administruar në dosjen e ILDKPKI-së, faqe **, mandat arkëtimi me nr.serial *** i datës **.1.2014.

2.9.3 Në DV-2010, në rubrikën e detyrimeve, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *paguar 40.000 euro + 30.000 euro për dy apartamente banimi*, pra një total prej 70.000 euro. Ndërkohë, në DV- 2013 nuk rezulton që subjekti të ketë deklaruar shlyerje detyrimi lidhur me këtë pagesë.

2.9.4 Bazuar në sa më sipër, referuar akteve në dosje, vlerësohet se konkluzioni i Komisionit mbi shlyerjen e pagesës së këstit të fundit të pasurive apartament banimi, në vitin 2010, në një periudhë të ndryshme nga ajo e dokumentuar¹³, mandat arkëtimi në arkën e shoqërisë për pagesën e shumës 11.284 euro që mban datën **.1.2014, nuk është i drejtë. Pretendimet e subjektit lidhur me kryerjen e pagesës së këstit në vitin 2010, mbeten në nivel deklarativ e të pambështetura në provat e administruara gjatë hetimit administrativ, përfshirë dhe deklarimin e subjekti i rivlerësimit në deklaratën periodike vjetore të vitit 2010, e cila në konsideratë dhe të jurisprudencës së Kolegjit përbën edhe ajo provë në këtë proces, në të cilën rezulton e deklaruar vetëm shlyerja e shumës prej 70.000 euro për pagesat e pasurive në fjalë.

2.9.5 Për sa arsyetuar gjerësisht më sipër, vlerësohet se edhe pas prapësimeve ndaj rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provonte të kundërtën e barrës së provës mbi burimet e ligjshme të pagesës së këstit të fundit të pasurisë, në janar të vitit 2014, duke rezultuar në pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme për shlyerjen e këtij detyrimi.

3. Analiza financiare për periudhën objekt kontrolli

3.1 Komisioni, në përfundim të hetimit administrativ, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka konstatuar se: *[...] duket se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme nga burime të dokumentuara, për blerje/krijim të pasurive, si dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruara dhe evidentuara, duke rezultuar me balancë negative në shumën - 10.336.555 lekë [...]*¹⁴.

3.2 Pasi ka vlerësuar prapësimet dhe provat e depozituara nga subjekti i rivlerësimit (analizuar më sipër përgjatë analizës së pasurive të deklaruara në deklaratën Vetting dhe gjetjet e rezultuara gjatë hetimit administrativ), Komisioni ka arritur në konkluzionin se ato kanë nivel besueshmërie dhe provueshmërie të mjaftueshëm. Pasi ka reflektuar pretendimet e subjektit në analizën financiare, në përfundim Komisionit i ka rezultuar se pamundësia financiare e subjektit të rivlerësimit zbret në vlerën totale -1.540.670 lekë.

¹³ Respektivisht se pagesa në vlerën 10.000 euro është kryer në fund të vitit 2010 dhe 1.284 euro në fund të vitit 2013.

¹⁴ Në këtë diferencë negative, paraqitur me Rezultatet Paraprake të Hetimit Administrativ, janë të përfshira dhe pamjaftueshmëritë e burimeve të ligjshme në krijimin e pasurive apartament me vendodhje Tiranë për pagesat e kësteve në vitet 2009 dhe 2014, trajtuar gjerësisht në shkakun e parë ankimor.

3.3 **Drejtuesi i Prokurorisë, lidhur** me sa më sipër, në zbatim dhe të Rekomandimit të ONM-së datë 6.12.2024, ndan qëndrim të ndryshëm nga Komisioni, për sa do të trajtohet në vijim:

3.3.1 *Lidhur me pamjaftueshmërinë e konstatuar nga Komisioni për vitin 2008, (fillimisht në shumën - 4.541.402 lekë)*, rezulton se Komisioni, pasi ka vlerësuar shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti, ka rishikuar analizën financiare dhe ka vlerësuar se për vitin 2008 subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të mbulojnë me burime të ligjshme shpenzimet dhe investimet e këtij¹⁵. **Drejtuesi i Prokurorisë**, për sa ka argumentuar gjerësisht më sipër në këto parashtime, në trajtimin e pasurive apartament banimi me vendodhje në Tiranë, vlerëson të pabazuar arsyetimin dhe konkluzionin e Komisionit. Në analizën financiare të kësaj periudhe, duhet të mbahet në konsideratë sa rezultuar gjatë hetimit, se personi i lidhur me subjektin në DV – 2008¹⁶, ka deklaruar në pronësi pasuri apartament banimi në Vlorë, në posedim nga subjekti¹⁷ dhe kursime në cash dhe në bankë, në shumën totale 40.000 euro¹⁸. Për sa trajtuar dhe më sipër në këtë parashtesë, vlerësohet se të ardhurat e ligjshme në kuptim të nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës, nuk janë të mjaftueshme për të mbuluar investimet, kursimet dhe shpenzimet e jetesës së personit të lidhur me subjektin, për të njëjtën periudhë kontrolli.

3.3.2 *Lidhur me pamjaftueshmërinë e konstatuar për vitin 2010, fillimisht në shumën - 2.553.889 lekë*, rezulton se Komisioni, pasi ka vlerësuar shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, ka rishikuar analizën financiare, duke vlerësuar në përfundim se për vitin 2010 subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të mbulojnë me burime të ligjshme shpenzimet dhe investimet e këtij¹⁹. **Drejtuesi i Prokurorisë** konstaton se, referuar deklarimeve periodike vjetore, rezulton se: në DV-2008 subjekti dhe personi i lidhur me të, deklarojnë kursime *cash* në shumën 500.000 lekë; në DV-2009 deklarojnë kursime *cash* në shumën 200.000 lekë ndërsa në DV-2010 personi i lidhur me subjektin, deklaroi blerjen e një pasurie automjet në vlerë 980.000 lekë me burim krijimi “*kursimet tona*”. Sikundër trajtuar dhe më sipër në këtë parashtesë, lidhur me *momentin* e pagesës së kështit të fundit në vlerën 11.284 euro të pasurive apartamente banimi, në Tiranë, pretendimi i subjektit gjatë hetimit administrativ, se: [...] *shuma 10.000 euro për pagesën pjesore të kështit të fundit të këtyre pasurive është paguar në vitin 2010 me burim kursime të deklaruara* [...], duket se nuk gjen mbështetje në deklaratimet e subjektit në DV-2010, deklarim sipas të cilit

¹⁵ Në vendimin e arsyetuar analiza paraqitet me balancën pozitive prej 385.898 lekë nga balanca negative në shumën - 4.541.402 lekë referuar rezultateve të hetimit administrativ.

¹⁶ Në deklaratën e interesave periodike vjetore, dorëzuar në ILDKPKI në vitin 2008, në cilësinë e personit të lidhur me subjektin e rivlerësimit.

¹⁷ Deklaruar në deklaratën “Vetting”, krijuar/blerë nga bashkëshorti i subjektit disa muaj përpara martesës ligjore dhe përdorur pa pagesë nga subjekti kohë përpara blerjes.

¹⁸ Të deklaruara në DV-2008, se janë deklaruar përdorur për pagesën e kështit të parë të pasurisë së përbashkët.

¹⁹ Në vendimin e arsyetuar paraqitet me balancën pozitive prej 486.686 lekë (prg. 5.16 i vendimit të arsyetuar) nga balanca negative në shumën prej - 2.553.889 lekë, referuar rezultateve të hetimit administrativ.

duket se kursimet e viteve të mëparshme (2008-2009, në total 700.000 lekë), së bashku me të ardhurat e vitit 2010, janë përdorur për blerjen e automjetit tip *Mercedes Benz*, në qershor të vitit 2010. Rrjedhimisht, vlerësohet e pabazuar analiza e kryer nga Komisioni në vendimin e arsyetuar, bazuar në pretendimet e subjektit gjatë hetimit administrativ.

3.3.2.1 Gjithashtu, vlerësohet i pabazuar edhe rishikimi i analizës financiare nga Komisioni për këtë vit (viti 2010), mbështetur në pretendimet e subjektit, se shumat e evidentuara gjatë hetimit administrativ, të tërhequra nga llogaria bankare (në shumën totale prej 2.948.863 lekë²⁰) nuk janë përdorur nga bashkëshorti i saj dhe rrjedhimisht, nuk duhet të përfshihen në shpenzimet e periudhës. Pretendimet e subjektit mbetën në nivel deklarativ dhe të paprovuara dhe jo në përputhje me legjislacionin e fushës edhe në përfundim të hetimit administrativ²¹.

3.3.2.2 Po ashtu, lidhur me trajtimin dhe arsyetimin e Komisionit mbi *zëra të analizës financiare të vitit 2010*, konstatohet se shuma prej 12.249 euro, e depozituar në llogarinë bankare të bashkëshortit të subjektit pranë *** Bank (ish-***), në datat **.3.2010, për të cilat subjekti i rivlerësimit ka deklaruar gjatë hetimit administrativ, se edhe nëse do të ishin kryer nga subjekti dhe personi i lidhur me të, do të ishin mbuluar nga kursimet e mëparshme në cash, vlerësohet se tejkalon kursimet cash të deklaruara të akumuluar deri në fund të vitit 2009 (në vlerën totale 700.000 lekë)²², duke afektuar burimet e ligjshme të tyre.

3.3.3 Lidhur me pamjaftueshmërinë e konstatuar nga Komisioni për **vitin 2014**, fillimisht në vlerën – 1.081.481 lekë, rezulton se pasi ka vlerësuar shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni ka rishikuar analizën financiare të këtij viti, duke vlerësuar përfundimisht se për vitin 2014, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, mbulojnë me burime të ligjshme shpenzimet dhe investimet e këtij viti. Sikundër trajtuar më sipër, në analizimin e burimit të krijimit të pasurive apartamente banimi në Tiranë, për gjithë sa argumentuar gjerësisht në këtë parashtrësë, vlerësohet se në analizën financiare të vitit 2014, në zërin shpenzim duhet të përfshihet pagesa e kështit të fundit të pasurive, mbështetur në mandat arkëtimin e depozituar në dosje, shpenzim që do të afektonte dhe rezultatin financiar të vitit 2014.

3.4 Për sa më sipër trajtuar, mbështetur edhe në Rekomandimin e ONM-së datë 6.12.2024, Drejtuesi i Prokurorisë, vlerëson se edhe në përfundim të hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit nuk provoi të kundërtën e barrës së provës, duke rezultuar me

²⁰ Për të cilat, subjektit, me rezultatet e hetimit administrativ ju kalua barra e provës, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, për të provuar burimet e ligjshme të shumave të kredituara në llogarinë bankare për periudhën **.3.2010-**.6.2010, në vlerën rreth 23.749 euro dhe destinacionin e përdorimit të shumave të debituar në vlerën rreth 21.250 euro.

²¹ Referohuni prapësimeve të subjektit të rivlerësimit lidhur me destinacionin e shumave të tërhequra nga llogaria bankare, konstatuar nga Komisioni gjatë hetimit administrative.

²² Referuar arsyetimit të Komisionit “Në lidhje me pagesën e 10 mijë euro dhe lidhur me transaksionet e kryera në llogarinë bankare në *** Bank”, f. **.3 të Vendimit.

mungesë të burimeve të ligjshme për të justifikuar pasuritë e saj dhe personit të lidhur me të dhe mbulimin e shpenzimeve të evidentuara gjatë hetimit. Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm lidhur me këto pasuri, referuar kërkesave të parashikuara në nenin D të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61 pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

I. B Çështje të tjera

4. Pasuria: Tokë me sipërfaqe 500 m², ndodhur në ***, Vlorë

4.1. Në D-Vetting dhe DV-2014, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar: [...] pasuri e paluajtshme (tokë) me sip. 500 m², të ndodhur në ***, përfituar në bazë të kontratës së dhurimit nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.5.2014, me dhurues shtetasit **. **, **. **, dhe **. **. [...] ²³.

4.2. Nga aktet në dosje, ka rezultuar se sipas kontratës së dhurimit nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.5.2014, në cilësinë e dhuruesit janë shtetasit **. **, (i përfaqësuar nga **. **), **. **. (e përfaqësuar nga **. **), **. **. dhe bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, z. *** ***, në cilësinë e pranuesit të dhurimit ²⁴.

4.3. Komisioni bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të hetimeve, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, duke i kërkuar:

- të depozitojnë dokumentacion ligjor për të provuar ligjshmërinë e krijimit të kësaj pasurie;
- të depozitojnë dokumentacionin ligjor provues të regjistrimit të pronës në emër të bashkëshortit të saj, si dhe dokumentacionin ligjor provues të regjistrimit të pronës në emër të familjes ***, pranë ASHK Vlorë;

²³ Lidhur me arsyet e dhurimit të kësaj pasurie, subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit nr. 2 të Komisionit, ka deklaruar se [...] Bashkëshorti im ka pasur njohje të hershme fillimisht me shtetasin **. **, **, më pas me dy vëllezërit e tij, shtetasin **. **, dhe **. **. Shtetasi **. **, dhe vëllezërit **. janë në lidhje familjare, kushërinj të parë. Në cilësinë e avokatit, bashkëshorti ka ofruar konsulencë juridike në lidhje me procesin e regjistrimit të pasurive të llojit tokë bujqësore, me vendndodhje fshati ***, të trashëguara nga gjyshi i tyre shtetasi **. **, Bashkëshorti im ka ndjekur edhe procedurën e regjistrimit të pasurive pranë zyrës së regjistrimit Vlorë ²³[...]. Subjekti ka depozituar deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.5.2024, të shtetasit **. **, në të cilën deklaron se [...] Me avokat *** **n kam njohje që në fëmijëri. Arsyja e dhurimit të sipërfaqes prej 500 m² sipas kontratës së dhurimit nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.5.2014, pjesë e pasurisë (tokë me sipërfaqe mijëra ha) që kemi trashëguar nga i ndjeri gjyshi im *** **, ka qenë vlerësim për konsulencën juridike dhe punën që avokati ka kryer në lidhje me regjistrimin e tyre, të ndodhura në ***, Vlorë [...]. Subjekti ka deklaruar se në rastin konkret, konsulencia juridike që u është ofruar nga bashkëshorti pjesëtarëve të familjes ***, ashtu edhe ndjekja e procesit të regjistrimit të pronës, nuk ka pasur për qëllim marrjen e një shpërblimi, sepse në të kundërt do të ishte bashkëshorti që do të përcaktonte vlerën e shpërblimit për punën e kryer. Bashkëshorti i ka orientuar, sugjeruar, këshilluar e ndihmuar dhe fakti që disa vite më vonë nga ofrimi i konsulencës juridike është bërë ky dhurim, ka qenë në kontekstin e mirënjohjes.

²⁴ Në kontratë përcaktohet gjithashtu se: Pala dhuruese ka dëshirë t'i dhurojë palës pranuese të dhurimit të gjithë parcelën e sipërpërmendur dhe për ketë kanë vendosur t'ia dhurojnë palës pranuese të dhurimit këtë parcelë. Pas përfitimit nga dhurimi pala pranuese e dhurimit bëhet pronar i ligjshëm i kësaj parcele. Pas firmosjes së kësaj kontrate dhe regjistrimit të saj në ZVRPP Vlorë pala përfituese e dhurimit bëhet pronar i ligjshëm i pronësisë.

- të depozitojnë foto aktuale të pronës në emër të bashkëshortit të saj.

4.4. Subjekti në prapësimet ndaj rezultateve të hetimit administrativ të Komisionit, ka mbajtur të njëjtin qëndrim sikundër edhe gjatë procesit të hetimit administrativ duke ju qëndruar të njëjtave pretendime dhe prova²⁵.

4.5. Komisioni, në përfundim, lidhur me këtë pasuri, ka vlerësuar se: [...] *toka bujqësore objekt analize vjen si pasojë e një akti dhurimi, i përpiluar me vullnetin e lirë të personave për shkak si të marrëdhënies me personin e lidhur, por dhe të ndihmës juridike që i ky i fundit i ka dhënë. Nga hetimi u provua se kjo pasuri nuk vjen si pasojë e një kontrate shërbimi për të cilën personi i lidhur do të kishte detyrimin të paguante detyrimet tatimore. Ky qëndrim është koherent si në kontratën e dhurimit, në deklaratën noteriale, gjatë procesit, edhe në deklaratimet e subjektit gjatë procesit të rivlerësimit. Ky akt nuk përbën një rast konflikti interesi për subjektin dhe nuk ka asnjë element që mund të jetë një indicie për ndikimin e subjektit në këtë pasuri [...].*

4.6. **Drejtuesi i Prokurorisë**, në zbatim të Rekomandimit të ONM-së datë 6.12.2024, për sa më sipër ndan qëndrim të ndryshëm nga Komisioni, pasi vlerëson se përfundimi i arritur mbi këtë pasuri, duket se nuk është rezultat i një analize të plotë, në përputhje me provat e administruara dhe vlerën e tyre provuese. Referuar dokumentacionit të administruar në dosje të Komisionit dhe shpjegimeve të subjektit, në gjendjen që janë aktet, mbetet e paqartë dhe jo ezauruese në drejtim të largimit të çdo dyshimi të arsyeshëm, nëse marrëdhënia e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit me dhuruesit, ka qenë shpërblim, pagesë, kompensim për shërbimet ligjore të ofruara nga bashkëshorti i subjektit, për të cilën duke e trajtuar si dhurim nuk është lëshuar faturë dhe nuk është kryer pagesë e detyrimeve tatimore, apo thjesht në kuadrin e mirënjohjes për dhënien e një asistencë teknike, orientuese ligjore²⁶.

²⁵ Lidhur me arsyet e dhurimit të kësaj pasurie, subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit nr. 2 të Komisionit, ka deklaruar se [...] Bashkëshorti im ka pasur njohje të hershme fillimisht me shtetasin ** ***, më pas me dy vëllezërit e tij, shtetasin **, ** dhe **, **.. Shtetasi **, ** dhe vëllezërit **, janë në lidhje familjare, kushërinj të parë. Në cilësinë e avokatit, bashkëshorti ka ofruar konsulencë juridike në lidhje me procesin e regjistrimit të pasurive të llojit tokë bujqësore, me vendndodhje fshati ***, të trashëguara nga gjyshi i tyre shtetasi **, **. Bashkëshorti im ka ndjekur edhe procedurën e regjistrimit të pasurive pranë zyrës së regjistrimit Vlorë [...]. Në lidhje me këtë dhurim, subjekti ka depozituar deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.5.2024, të shtetasit **, **. në të cilën deklaron se [...] Me avokat *** **n kam njohje që në fëmijëri. Arsyeja e dhurimit të sipërfaqes prej 500 m² sipas kontratës së dhurimit nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.5.2014, pjesë e pasurisë (tokë me sipërfaqe mijëra ha) që kemi trashëguar nga i ndjeri gjyshi im *** **, ka qenë vlerësim për konsulencën juridike dhe punën që avokati ka kryer në lidhje me regjistrimin e tyre, të ndodhura në ***, Vlorë[...]. Subjekti ka deklaruar se në rastin konkret, konsulenca juridike që u është ofruar nga bashkëshorti pjesëtarëve të familjes **, ashtu edhe ndjekja e procesit të regjistrimit të pronës, nuk ka pasur për qëllim marrjen e një shpërblimi, sepse në të kundërt do të ishte bashkëshorti që do të përcaktonte vlerën e shpërblimit për punën e kryer. Bashkëshorti i ka orientuar, sugjeruar, këshilluar e ndihmuar dhe fakti që disa vite më vonë nga ofrimi i konsulencës juridike është bërë ky dhurim, ka qenë në kontekstin e mirënjohjes

²⁶ Nga aktet e administruara deri në këtë fazë të procesit nuk duket që të jetë e provuar, nëse ka pasur ndonjë procedurë gjyqësore, në të cilën bashkëshorti i subjektit ka marrë pjesë për të mbrojtur palët e përfshira në dhurim, nëse ai është kujdesur për regjistrimin e këtyre pasurive në ZVRPP-në e Vlorës apo të ketë asistuar

5. Ndërtim informal në proces legalizimi, i deklaruar nga babai i bashkëshortit të subjektit

5.1 Gjatë hetimit administrativ të Komisionit, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, me shkresën nr. ***/** prot., datë **.1.2021, ka informuar Komisionin se nga verifikimi në bazën digjitale të të dhënave të vetë deklarimeve, shtetasit **. **. **. (vjehtëri i subjektit) dhe **. **. **., rezultojnë aplikues në procesin e legalizimit: *regjistri i deklaratave nr. *** prot., datë **.3.2014, ***, Vlorë.*

5.2 Në përgjigje të pyetësorit nr. 3 të Komisionit, subjekti i rivlerësimit ka depozituar kopje të firmosur të deklaratës për përfshirje në procedurat e legalizimit të ndërtimit pa leje dhe/ose shtesës në ndërtim me leje, të shtetasve **. **. **. dhe **. **. **. të datës **.10.2014, të cilët deklarojnë se *ndërtimi është kryer pa leje në vitin 2008, në fshatin ***, lagjja “**-**”, pranë vilave “****”.* Subjekti ka depozituar certifikata familjare të dy deklaruesve, si dhe foto të objektit dhe dokumentacion financiar, për të provuar të ardhurat e ligjshme nga punësimi në Itali të shtetasit **. **. **. Po në përgjigje të këtij pyetësi subjekti ka deklaruar se sikundër rezultojnë nga fotot, objekti ndërtimor është një garazh.

5.3 Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni i ka kërkuar subjektit *shpjegime mbi marrëdhënien e vjehtërit të saj me shtetasen **. **. **., informacion në lidhje me personin që ka investuar në ndërtimin e objektit, si dhe të depozitave foto aktuale të tij.*

5.4 Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet e saj, ka parashtruar, ndër të tjera, se marrëdhënia juridiko-civile, që vjehtëri i saj ka krijuar në vitin 2008 me shtetasen **. **. **, është një marrëdhënie ligjore që nuk i përket as asaj dhe as bashkëshortit²⁷. Ndërsa, për sa i përket investimit në ndërtimin e objektit, subjekti ka vlerësuar se ai duhet të jetë i përbashkët.

5.5 Komisioni, në përfundim, ka vlerësuar se: *[...] në analizë të provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit, Komisioni çmon se nuk rezultuan indicie apo prova që kanë të bëjnë me procesin e rivlerësimit të subjektit [...].*

5.6 **Drejtuesi i Prokurorisë**, në zbatim të Rekomandimit të ONM-së datë 6.12.2024, vlerëson se nga hetimi ka rezultuar se shtetasi *** ***(vjehtëri i subjektit të rivlerësimit) dhe shtetasi **. **. **, janë aplikues në procesin e legalizimit të një ndërtese ndërtuar pa leje në fshatin ***²⁸. Nga aktet e administruara gjatë hetimit administrativ ka rezultuar se

me procedurat e kompensimit pranë Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, në mënyrë që të arrihej një konkluzion përfundimtar mbi ligjshmërinë e krijimit të kësaj pasurie.

²⁷ Referuar çfarë i është komunikuar nga vjehtëri se vjehtëri ka pasur marrëdhënie/njohje të hershme shoqërore me bashkëshortin e shtetasës ***, aktualisht është e pamundur të marrë shpjegime prej tij, sepse ai është diagnostikuar me diagnozën “Memory Impairment” (dëmtim i kujtesës).

²⁸ Agjencia Shtetërore e Kadastrës, me shkresën nr. ***/** prot., datë **.1.2021, informon Komisionin se nga verifikimi në bazën digjitale të të dhënave të vetëdeklarimeve, subjektet e përmendura në shkresë

në datën e firmosjes së deklaratës mbi procedurën e legalizimit, vjehri i subjektit të rivlerësimit nuk ka qenë në Shqipëri, por në Itali, atje ku banon që pas viteve '90, ndërkohë që përgjatë vitit 2008, vit në të cilin është deklaruar se është ngritur ndërtimi pa leje, nga të dhënat e sistemit TIMS, ka rezultuar se ai ka qenë në Shqipëri për një periudhë 18 ditore²⁹.

5.6.1 Referuar fotove të këtij ndërtimi, depozituar nga vetë subjekti i rivlerësimit, duket se zona ku është ky ndërtim është e rrethuar nga një gardh me hyrje, i përbërë nga një sipërfaqe e konsiderueshme toke, çka bën kontradiktor deklarin e subjektit mbi arsyen e ndërtimit të një garazhi.

5.6.2 Referuar dokumentacionit të depozituar nga vetë subjekti i rivlerësimit, sipas prokurës së posaçme nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.12.2009, ka rezultuar se vajza e shtetasit **. **. **, **** **, ka autorizuar avokatin *** **, bashkëshortin e subjektit të rivlerësimit, për të bërë mbrojtjen në çështjen penale për të cilën ajo akuzohej pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Vlorë. Shtetasja *** **, ka qenë nën hetim nga Prokuroria Vlorë në vitin 2009 dhe është gjykuar për veprën penale të parashikuar nga neni 186/3 dhe neni 248 i K.Penal, në lidhje me regjistrimin e një sipërfaqe trualli, të qytetit të Vlorës (*për shkak të funksionit shtetëror që ajo kryente*).

5.6.3 Referuar të dhënave të sistemit TIMS, rezulton se bashkëshorti i subjektit dhe shtetasja *** **. kanë udhëtuar së bashku në vitin 2011, me automjetin me targa ** *** ** nëpërmjet kufirit të Kakavijës, në datë **.11.2011 (*dalje/hyrje në të njëjtën ditë*).

5.7 Në këto rrethana, vlerësohet se konkluzioni i Komisionit lidhur me këtë pasuri, duket se nuk është i plotë dhe përmban elementë të mjaftueshëm për t'iu nënshtruar juridiksionit kontrollues të Kolegjit, pasi rrethanat e rezultuara në përfundim të hetimit administrativ, duket se lidhen më shumë me personin e lidhur të subjektit të rivlerësimit.

5.7.1 Për sa më sipër, **Drejtuesi i Prokurorisë** vlerëson se këto rrethana të konstatuara sa më lart, duhen mbajtur në konsideratë eventualisht për vlerësimin tërësor të procedurës së rivlerësimit, në kuptim të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016.

II.A Lidhur me kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale

6. Gjatë hetimit administrativ të Komisionit, nga të dhënat e sistemit TIMS ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj, kanë udhëtuar në datën **.11.2015, me shtetasin *** ** dhe bashkëshorten e tij, ndërsa vetë bashkëshorti i subjektit ka udhëtuar me këtë shtetas, më datë 19.2.2016.

rezultojnë aplikues në procesin e legalizimit: **. **. ** dhe **. **. **, regjistri i deklaratave nr. *** prot., datë ***.3.2014, ***, Vlorë.

²⁹ Hyr në Shqipëri në datën **.7.2008 dhe dalje nga Shqipëria në datë **.8.2008.

6.1 Subjekti i rivlerësimit në përgjigje të pyetësorit nr. 3 të Komisionit, ndër të tjera, ka deklaruar se: [...] *Kam njohje shoqërore me bashkëshorten e shtetasit *** ***, shtetasen *** ***. Kjo shtetase ushtron detyrën e noteres që prej vitit 2014. Njohja jonë ka lindur kur kemi udhëtuar së bashku, në muajin nëntor të vitit 2015. Arsyeja e udhëtimit nga data **.11.2015 deri në datën **.11 .2015, sikundër është sqaruar dhe në pyetësorin e parë, ka qenë udhëtim pune në Itali i bashkëshortit tim. Në këtë udhëtim pune të bashkëshortit tim, përveç meje dhe djalit tim...kanë qenë dhe shtetasit *** ***dhe *** *** (bashkëshortë) dhe udhëtimi është kryer me automjetin në përdorim të tyre. Udhëtimi që bashkëshorti ka kryer me shtetasin *** ***në datën **.02.2016, për arsye pune [...].*

6.2 Nga aktet në dosje, rezulton se Komisioni ka kërkuar informacion pranë Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, e cila me shkresën nr. ***/** prot., datë **.6.2024, ndër të tjera, ka informuar Komisionin se në lidhje me shtetasin *** ***rezulton: [...] *Në ish-Prokurorinë e Krimeve të Rënda është regjistruar procedimi penal me nr. **/**, viti 2018, në ngarkim të shtetasit *** ***, për veprën penale të parashikuar nga neni 283/a/2 i Kodit Penal. Pas kryerjes se hetimeve në lidhje me këtë procedim penal është vendosur shpallja e moskompetencës dhe kalimi i akteve në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Vlorë, datë **.6.2018 [...].*

6.3 Në përgjigje të kërkesës së Komisionit, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë,³⁰ ka informuar, ndër të tjera, se: [...] *për shtetasin *** ***, regjistruar (1) Procedimi penal në ish-Krimet e Rënda me nr. **/*, viti 2018, për veprën penale të parashikuar nga neni 283/a-2 i Kodit Penal, i cili është transferuar pranë Prokurorisë Vlorë më datë **.6.2018, rezulton të jetë regjistruar si procedim penal me nr. ***/2018 për veprën penale të parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal³¹, e cila në përfundim të hetimeve është dërguar me kërkesë për miratim të marrëveshjes penale në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë...(2) Procedimi penal nr. ***/2020 për veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale apo veprimtarisë kriminale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, e cila në përfundim të hetimeve është dërguar me kërkesë për pushim të çështjes penale në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë[...].*

6.4 Komisionit i ka rezultuar se në kërkesën e datës **.7.2021 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, në pikën 2 të saj, prokurori ka konstatuar se: [...] *Sikurse rezultoi në fazën e hetimit paraprak ndaj shtetasit *** ***, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, ka regjistruar procedimin penal nr. ****, datë **.8.2012, për veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale apo veprimtarisë kriminale”,*

³⁰ Me shkresën nr. **** prot., datë **.9.2024

³¹ Neni 300 i Kodit Penal – “Moskallëzim krimi”.

parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal. Për këtë procedim penal me vendimin e datës **7.2015 është disponuar për pushimin e çështjes në mbështetje të neneve 24/2 dhe 328, pika 1, shkronja “b”, dhe neni 329 të Kodit të Procedurës Penale, pasi fakti i referuar nuk parashikohet nga ligji si vepër penale [...].

6.5 Nga procedimi penal nr. **** i vitit 2012, ka rezultuar se shtetasi *** *** është proceduar nga ana e Prokurorisë Vlorë për një nga veprat penale të parashikuar në pikën 1, të nenit 3 të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, të ndryshuar. Pavarësisht se procedimi penal është pushuar, shtetasi *** ***, bazuar në pikën 15, të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, konsiderohet person i përfshirë në krimin e organizuar.

6.6 Neni DH i Aneksit të Kushtetutës përcakton kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit. Qëllimi i dispozitës kushtetuese është të identifikojë ato subjekte të cilat kanë kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar. Nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën.

6.7 Referuar ligjit nr. 84/2016, në pikën 15, të nenit 3 të tij, parashikohet se: “Person i përfshirë në krimin e organizuar është çdo person që është dënuar apo proceduar penalisht brenda dhe jashtë territorit të R. Sh. për një nga veprat e parashikuara në pikën 1 të nenit 3 të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”.

6.8 Në deklaratën për kontrollin e figurës, në rubrikën “Të dhëna për sigurinë”, në pikën “c”, në lidhje me pyetjen se a ka pasur kontakte të papërshtatshme në formën e një takimi, komunikimi elektronik, ose çfarëdolloj mënyre tjetër takimi të qëllimshëm me një ose më shumë persona të përfshirë në krimin e organizuar, që nuk është në pajtim me ushtrimin e detyrës, subjekti i rivlerësimit i është përgjigjur “Jo”.

6.9 Sa më sipër, Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar subjektit barrën e provës, për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimit të Komisionit, pasi duket se shtetasi *** ***hyn në rrethin e personave të përfshirë në krimin e organizuar dhe nuk është deklaruar ky fakt gjatë plotësimit të formularit për kontrollin e figurës, sipas parashikimit të nenit DH, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 39 pika 2 të ligjit nr. 84/2016.

6.10 Pasi ka vlerësuar prapësimet e subjektit të rivlerësimit, Komisioni në përfundim ka arsyetuar se: [...] trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit, znj. Eranda Laze, ka plotësuar në mënyrë korrekte deklaratën për kontrollin e figurës, pavarësisht dijenisë ose jo të saj lidhur me procedimin penal nr. **** të vitit 2012 për veprën “Pastrimi i

produkteve të veprës penale”. Formalisht, emri i shtetasit **.**. nuk figuron si person i regjistruar në regjistrin e veprave penale si autor i veprës penale dhe, për pasojë, ai nuk mund të konsiderohet si kontakt i papërshtatshëm në kuptim të pikës 1 të nenit 3 të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar”. Nga ana tjetër, udhëtimi i subjektit me persona të cilët mbrohen nga bashkëshorti i saj si avokat, tregon që subjekti i rivlerësimit duhet të tregojë një kujdes të shtuar lidhur me këtë fakt, me qëllim eliminimin e këtyre situatave, të cilat në dukje mund të sjellin probleme lidhur me etikën e një magjistrati, pavarësisht faktit se në asnjë rast nga hetimi nuk rezultoi që subjekti të ketë vepruar në gjendje konflikti interesi [...].

6.11 **Drejtuesi i Prokurorisë**, në zbatim të Rekomandimit të ONM-së të datës 6.12.2024, në analizë të akteve në dosje, rezultateve të hetimit, si dhe prapësimeve të subjektit të rivlerësimit, ndan vlerësim të ndryshëm nga Komisioni, për sa trajtohet në vijim:

6.11.1 Procedimi penal nr. **** i vitit 2012, është regjistruar në Prokurorinë Vlorë dhe rezulton të jetë hetuar për një periudhë tre vjeçare në të njëjtën prokurori ku subjekti i rivlerësimit ka ushtruar detyrën për më shumë se 10 vite, deri kur për këtë procedim, me vendimin e datës **.7.2015, është disponuar për pushimin e çështjes, pasi fakti i referuar nuk parashikohet nga ligji si vepër penale. Nga sistemi TIMS, ka rezultuar se në datën *.11.2015, rreth tre muaj pas vendimit për pushimin e këtij procedimi penal, subjekti i rivlerësimit ka udhëtuar me shtetasin *** dhe bashkëshorten e tij.

6.12 **Drejtuesi i Prokurorisë**, në zbatim të Rekomandimit të ONM-së të datës 6.12.2024, i vlerëson jobindëse pretendimet e subjektit mbi këtë udhëtim familjar, se [...] nuk kanë patur njohje të mëparshme, por bëhet fjalë për një udhëtim pune të bashkëshortit tim, ku përveç meje dhe djalit tim, kanë qenë dhe shtetasit *** dhe *** (bashkëshortë) dhe udhëtimi është kryer me automjetin në përdorim të tyre [...], si dhe pretendimin e mungesës së dijenisë për zhvillimet e një procedimi penal për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal.

6.12.1 **Drejtuesi i Prokurorisë** në konsideratë dhe të jurisprudencës së Kolegjit³², vlerëson se pretendimet e subjektit duken si një përpjekje për të provuar të kundërtën e rrethanave të dala nga hetimi administrativ, por nga ana tjetër bien ndesh, me nevojën për vëmendjen e shtuar lidhur me rrethin shoqëror, që mund të frekuentojë një funksionare e lartë publike, pa cenuar perceptimin që përcjell në komunitet.

6.12.2 Fakti që bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka udhëtuar në vijim me shtetasin ***, në vitin 2016 dhe ka shërbyer si avokati i tij në procedimin penal nr. ***/**, në vitin 2018, të regjistruar në ish-Prokurorinë për Krimet e Rënda, për veprën penale të parashikuar nga neni 283/a-2 i Kodit Penal, janë rrethana që duhen vlerësuar në kuadër të

³² Referuar vendimit (JR) nr. 22/2022, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

dijenisë për marrëdhënien e subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me këtë shtetas, në referuar detyrimit ligjor për deklaram.

6.12.3 Subjekti i rivlerësimit në përgjigje të rezultateve të hetimit ka pretenduar se emri i shtetasit *** nuk është regjistruar në Regjistrin e Veprave Penale të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë, duke paraqitur dhe shkresën nr. ***/**, datë **.10.2024, lëshuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, e cila, ndër të tjera shprehet se [...] *në regjistrin e çështjeve penale nuk ka emër të regjistruar si person që i atribuohet kryerja e veprës penale, arrestuar/ndaluar apo si person i pandehur* [...].

6.12.4 Referuar kohëzgjatjes së hetimit të këtij procedimi penal (tre vjet), dispozitat e nenit 287 “Regjistrimi i njoftimit të veprave penale të Kodit të Pr. Penale” dhe Udhëzimin nr. 241 datë 21.11.2005, “*Për regjistrimin e njoftimit të veprës penale dhe të emrit të personit që i atribuohet vepra penale*”, pa vënë në diskutim vlerën provuese të dokumentit të paraqitur, nga aktet e administruara gjatë hetimit administrativ, Drejtuesi i Prokurorisë vëren se nuk duket se Komisioni të ketë administruar dosjen penale të çështjes në fjalë, për të konkluduar mbi pozitën procedurale të këtij shtetasi gjatë këtyre viteve.

6.13 **Drejtuesi i Prokurorisë** konstaton se situatat e rezultuara nga hetimi administrativ i Komisionit, edhe nëse nuk janë të tilla që shtetasi *** të konsiderohet si kontakt i papërshtatshëm, në kuptim të procesit të kontrollit të figurës, ashtu sikurse ka vlerësuar Komisioni, të analizuara së bashku e të para në raport me njëra-tjetrën në vlerësim tërësor të procedurave, duhen të ishin analizuar më së paku në kuadër të vlerësimit të etikës së subjektit të rivlerësimit dhe sjelljen që do të duhej të ishte e pranueshme për të pasur besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.

II B Lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale dhe tërësor të procedurave

7. Gjatë hetimit administrativ në Komision, subjektit të rivlerësimit i është kërkuar të japë shpjegime mbi disa udhëtime dhe kontakte me persona të përfshirë ose të dyshuar si të përfshirë ose/kanë qenë të përfshirë në aktivitete kriminale, për sa në vijim:

7.1 Nga të dhënat e sistemit TIMS, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj kanë udhëtuar me një automjet që ka qenë në përdorim të shtetasit *** dhe bashkëshorti i saj ka udhëtuar disa herë me shtetasin *** gjatë periudhës kohore 2017 – 2020.

7.2 Në lidhje me këtë konstatim, subjekti i rivlerësimit në përgjigje të pyetësorit nr. 3 të Komisionit, ndër të tjera, ka deklaruar se: [...] *Bashkëshorti ka marrë në përdorim nga shtetasi *** automjetin përkatës, gjithashtu ka marrë dhe automjetin me targa *** **, që është në pronësi të nënës së tij **, në mënyrë që të siguronte transportin tonë.

Me shtetasin **** bashkëshorti ka pasur dhe ka marrëdhënie pune. Udhëtimet me këtë shtetas kanë qenë të shpeshta për shkak të ndjekjes së procesit gjyqësor në Itali të vëllezërve të shtetasit ****, si dhe të kontakteve/komunikimeve që ka pasur me përfaqësuesit ligjorë të tyre jashtë shtetit... Bashkëshorti i ka përfaqësuar/përfaqëson edhe në proceset gjyqësore, që janë duke u zhvilluar ndaj tyre në Tiranë dhe Vlorë³³[...].

7.3 Komisioni referuar burimeve të hapura në media ka konstatuar se shtetasi **** akuzohet për vepra penale të lidhura me trafikimin ndërkombëtar të narkotikëve³⁴.

7.4 Nga informacioni i administruar nga Komisioni, në Prokurorinë pranë Prokurorisë së Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë³⁵, rezulton se për shtetasin **** është regjistruar procedimi penal me nr. ****/2020 për veprën penale të parashikuar nga nenet 274³⁶, 242³⁷ të Kodit Penal, për të cilën në përfundim të hetimeve është konkluduar me vendim pushimi. Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, me shkresën nr. ****/**, datë **.6.2024, ka informuar Komisionin se ndaj shtetasit **. ** nuk ka pasur dhe nuk ka të regjistruar çështje penale.

8. Nga të dhënat e sistemit TIMS ka rezultuar se subjekti dhe bashkëshorti i saj kanë udhëtuar në disa raste gjatë viteve 2019-2020, me vëllain e ****, shtetasin ****. Shtetasi ****, gjithashtu, ka rezultuar se ka depozituar 500 euro në llogarinë e bashkëshortit të subjektit, më datë **.1.2019.

8.1 Komisioni referuar burimeve të hapura, ka konstatuar se shtetasi **** është hetuar për vepra penale të lidhura me trafikimin ndërkombëtar të narkotikëve³⁸.

8.2 Subjekti i rivlerësimit në përgjigje të pyetësorit nr. 3 të Komisionit, ka deklaruar: [...] Bashkëshorti im, **** dhe shtetasi **** janë shokë, janë njohur në adoleshencë kur kanë qenë të angazhuar në të njëjtin klub sportiv dhe marrëdhëniet shoqërore ndërmjet tyre vijnë edhe sot. Shtetasi **** është vëllai i shtetasit **** dhe bashkëshorti im ka/ka pasur dhe me të raport shoqëror... Me shtetasin **** sqaroj se unë kam udhëtuar vetëm një herë dhe në këtë udhëtim kam qenë së bashku me bashkëshortin tim dhe shtetasi **** ka qenë me bashkëshorten e tij, shtetasen ****. Ky udhëtim i referohet periudhës **.5.2019 – **.5.2019 [...].

8.3 Me shkresën nr. **** prot., datë **.9.2024, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, ka informuar se për shtetasin **** është regjistruar procedimi penal me nr. ****/2021, për veprën penale të parashikuar nga neni 287

³³ Bashkëlidhur subjekti ka dërguar në Komision kopje të prokurave të përfaqësimit të anëtarëve të familjes **** nga ana e bashkëshortit të saj si dhe e-maile të avokatëve italianë me bashkëshortin e saj.

³⁴ https://www.***.com/sekuestrohet-karburanti-prone-e-familjes-***

³⁵ Shkresa nr. **/** prot., datë **.9.2024.

³⁶ Neni 274 “Prishja e qetësisë publike”.

³⁷ Neni 242 “Mosbindja ndaj urdhrat të punonjësit të policisë së rendit publik”.

³⁸ https://www.***.it/cronaca/lecce-arresto-eroina-albanesi-**-marzo-2015.html.

i Kodit Penal³⁹ dhe në regjistrin e njoftimeve të veprave penale nuk ka të regjistruar emër personi nën hetim. Ky procedim aktualisht është në proces hetimi.

9. Në vijim të sa më sipër konstatuar mbi të dy rastet, bazuar në nenin 52 të ligjit me nr. 84/2016, subjektit të rivlerësimit iu kërkua të japë shpjegime në lidhje me: (i) *përdorimin e automjetit të personit të proceduar penalisht*; (ii) *shoqërimin me persona me precedentë penalë*.

10. Pasi ka vlerësuar prapësimet e subjektit të rivlerësimit Komisioni, në përfundim ka konstatuar se: [...] *subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur dijeni mbi pronësinë e automjetit me të cilin ajo dhe familjarë të saj kanë udhëtuar për në Itali. Gjithashtu, nga dokumentacioni i dorëzuar në Komision nuk është konstatuar që shtetasi **.**, të ketë precedentë penalë. Gjithashtu, në momentin e udhëtimit me shtetasin **.**, dhe bashkëshorten e tij në vitin 2019, ndaj tij nuk ka pasur të regjistruar asnjë procedim penal në ngarkim të tij. Procedimi penal është regjistruar dy vite më vonë nga momenti i udhëtimit. Në përfundim, Komisioni ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit duhet të tregojë kujdesin e nevojshëm në lidhje me rrethanat që mund t'i sjellin cenim të etikës profesionale. Subjekti duhet të shmangë çdo situatë në dukje apo drejtpërdrejt që cenon angazhimin ndaj vlerave profesionale në lidhje me etikën dhe integritetin gjatë ushtrimit të funksionit [...].*

11. Drejtuesi i Prokurorisë, në zbatim të Rekomandimit të ONM-së të datës 6.12.2024, në analizë të akteve në dosje, rezultateve të hetimit, si dhe prapësimeve të subjektit të rivlerësimit, konstaton se rrethanat e rezultuara nga hetimi, duhen të analizohen në drejtim të vlerësimit të etikës dhe angazhimit ndaj sjelljes profesionale të subjektit të rivlerësimit.

11.1 Drejtuesi i Prokurorisë referon jurisprudencën e Kolegjit, ku ky i fundit argumenton se etika e magjistratëve nuk duhet vlerësuar vetëm gjatë përmbushjes së detyrave ligjore si magjistrat, por duhet të përfshijë edhe jetën private dhe aktivitetet jashtë-gjyqësore. Për këto arsye, parë nga këndvështrimi i vlerësimit të veprimeve të magjistratit nga një vëzhgues i thjeshtë⁴⁰, kontaktet e drejtpërdrejta ose të tërthorta me persona të përfshirë ose të dyshuar se janë përfshirë (ose kanë qenë) në aktivitete kriminale, rrethanat këto të dala gjatë hetimit, duket se bien ndesh me perceptimin e përshtatshmërisë dhe kujdesit në sjellje në jetën private që pritet nga një magjistrat dhe ndikojnë negativisht në besimin e publikut tek gjyqësori.

11.2 I njëjti konstatim duket se gjen zbatim edhe lidhur me qasjen që ka subjekti i rivlerësimit në pranimin e mbulimit të shpenzimeve të udhëtimit të saj, jashtë vendit, nga

³⁹ Neni 287 i Kodit Penal “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”.

⁴⁰ Shih “Vlera 4”, Sjellja e përshtatshme dhe dukja e saj në

https://www.***.org/documents/nigeria/publications/Otherpublications/Commentry_on_the_Bangalore_principles_of_Judicial_Conduct.pdf. Paragrafi 111, ndër të tjera: “[...] Më shumë rëndësi ka jo çfarë bën apo nuk bën një gjyqtar, por çfarë mendojnë të tjerët që ka bërë apo është në gjendje të bëjë [...]”

klientët e bashkëshortit të saj, në cilësinë e avokatit mbrojtës. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në përgjigje të pyetësorit standard të Komisionit, se: [...] *Unë personalisht nuk kam marrë ndonjë dhuratë me vlerë më të lartë se 500 euro, ndërsa në lidhje me financimin e shpenzimeve për udhëtimet jashtë shtetit, më duhet të sqaroj se bashkëshorti im ushtron profesionin e avokatit dhe në disa nga udhëtimet për shkak të punës të kryera prej tij dhe të mbuluara nga klientë të tij, kam qenë dhe unë bashkë me fëmijët e mi. Udhëtimet e punës të kryera në Itali nga bashkëshorti janë “shfrytëzuar” në funksion të takimit të familjarëve të bashkëshortit tim, familjarët e tij dy prindërit, motra e tij dhe vëllai i tij janë rezident në këtë shtet [...].*

11.3 Në prapësimet ndaj rezultateve të hetimeve, subjekti i rivlerësimit ka përsëritur gjithashtu se disa nga shpenzimet e udhëtimeve të saj me traget, janë mbuluar nga agjencitë e udhëtimeve detare, përkatësisht “*** ***” dhe “****” sh.p.k. Në një deklaratë të lëshuar nga të dyja kompanitë e mësipërme, thuhet se ato udhëtime kanë qenë pa pagesë për avokatin *** ***, në shenjë mirënjohje për gatishmërinë dhe shërbimet e dhëna për këtë kompani.

11.4 Edhe nga ky element faktik, megjithëse në mungesë të konfliktit të interesit, duket se subjekti i rivlerësimit ka treguar mungesë të një kujdesi të shtuar në veprimtarinë e saj jashtëgjyqësore, e cila ndikon në cenimin e imazhit të organit që përfaqëson akuzën në emër të shtetit.

11.5 Duke pranuar dhe njohur natyrën dhe vështirësinë e ekuilibrit që duhet të vendoset ndërmjet punës së bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit si avokat në fushën e të drejtës penale, ushtrimit të ligjshëm të profesionit të tij, në shumicën e rasteve në të njëjtin rreth ku subjekti i rivlerësimit punon si prokurore dhe përmbushjes së kërkesave ligjore në fuqi për sjelljen e një magjistrati brenda dhe jashtë sistemit gjyqësor, **Drejtuesi i Prokurorisë** konstaton se subjekti i rivlerësimit ka treguar mangësi në tregimin e një kujdesi të shtuar në veprimtarinë e saj jashtë-gjyqësore.

12. Drejtuesi i Prokurorisë, në zbatim të Rekomandimit të ONM-së datë 6.12.2024, për sa më sipër trajtuar në vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale, bazuar në treguesit e përcaktuar për vlerësimin e sjelljes së magjistratëve, çmon se gjetjet e rezultuara gjatë hetimit administrativ, janë të tilla që vijnë në kundërshti me sa parashikohet në nenin 3,

pika 5 të ligjit nr. 96/2016⁴¹, dhe udhëzimet ndërkombëtare, që rregullojnë sjelljen e magjistratëve, si brenda, ashtu edhe jashtë sistemit gjyqësor⁴².

13. Në përfundim të shqyrtimit të vendimit nr. 811/2024 të Komisionit, *Drejtuesi i Prokurorisë* në zbatim të Rekomandimit të ONM-së datë 6.12. 2024, në vlerësim tërësor të procedurave, vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk provoi të kundërtën e barrës së provës dhe nuk arrin nivel të besueshëm për konfirmimin e saj në detyrë.

III. KËRKIMI I ANKIMIT

14. Nisur nga parashikimi i nenit 179/b/5 të Kushtetutës dhe aneksit të Kushtetutës, konsiderojmë se vendimi i Komisionit nuk është në pajtueshmëri të plotë me gjendjen e fakteve dhe provave të administruar në fashikull, për krijimin e bindjes se subjekti i rivlerësimit arrin nivel të besueshëm për konfirmimin e tij në detyrë, në kuptim të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016;

15. Bazuar në kërkesat e neneve Ç, D, Dh, E dhe F të aneksit të Kushtetutës, nenin 4, pika 2, dhe nenin 61, pikat 3 dhe 5, të ligjit nr. 84/2016;

K Ë R K O J M Ë:

1. Të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelit shkaqet e këtij ankimi, dhe në zbatim të nenit 66, pika 1, germa “b” të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të shqyrtimit të çështjes në seancë publike, të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 811, datë 8.11.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe **shkarkimin nga detyra** të subjektit të rivlerësimit, znj. Eranda Laze.

DREJTUESI I PROKURORISË

PROKURORI I AUTORIZUAR

Altin DUMANI

Adnan XHOLI

⁴¹ [...] 5. Sjellja e magjistratit gjatë ushtrimit të funksionit dhe jashtë tij garanton ruajtjen dhe forcimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, profesioni ligjor dhe palëve në proces. Magjistrati ushtron funksionet me drejtësi, në mënyrë korrekte, në kohë të arsyeshme, të ndërgjegjshme, të kujdesshme, të zellshme dhe sistematike, me objektivitet, vetëpërmbytje dhe maturi.[...]

⁴² <https://rm.coe.int/168074738b> [...] 6. Prokurorët duhet të respektojnë standardet më të larta etike dhe profesionale, duke u sjelluar gjithmonë në mënyrë të paanshme dhe objektive. 97. Prokurorët duhet të fitojnë besimin e publikut duke treguar një sjellje shembullore në të gjitha rastet. Ata duhet të trajtojnë njerëzit në mënyrë të drejtë, të barabartë, me respekt dhe mirësjellje. Gjithashtu, ata duhet të respektojnë gjithmonë standardet më të larta profesionale dhe të ruajnë nderin dhe dinjitetin e profesionit të tyre, duke vepruar gjithmonë me integritet dhe kujdes [...].